

TRANSKRIPTI

6.2.2007

**P/L PËR TRAJTIMET E NDËRTIMEVE
PA LEJE**

LULZIM ZENELI përshëndes anëtarët e komisionit dhe mysafirët, ju falënderoj për ardhje dhe bashkëpunim. Ju kemi ftuar të dëgjojmë argumentet dhe opinionet e juaja drejtpërdrejt me çka do të ndikohet në ngritjen e kualitetit të këtij ligji. Kjo është një procedurë e zakonshme e komisionit parlamentar që me anë të dëgjimit publik të largohen dilemat edhe të dëgjojmë mundësitë konkrete që përmes vërejtjeve tuaja të inkorporohen si amendamente përkatëse. Ne kemi parapa të ftojme për këtë takim përfaqësuesit e komunave përmes kryeshefit dhe drejtorateve për urbanizëm, dy ministritë, agjensioni kadastral, fakulteti arkitekturës, nga shoqëria civile etj të cilët drejtpërdrejt mirën me këtë problematikë. Pa e zgjatur shumë po ju jap fjalën juve, pastaj anëtarëve të komisionit, por fillimisht përfaqësuesit të MMPH si propozuesit i ligjit dhe ju dëshiroj edhe një herë mirëseardhje.

MUHAMET ALIU, shfrytëzoi rastin të përshëndes të gjithë, veçanërisht komisionin parlamentar, institucionet komunale. Të gjithë jemi të vetëdijshtë se gjatë hartimit të legjislacionit kemi mungesë profesionale për hartimin e ligjeve sa më të mira, por megjithatë konsiderojmë se kemi bërë një punë të mirë. Komunat dhe IPQV-të tjera kanë pas raste edhe më herët sa ky dëgjim të shprehin mendimet e tyre për këtë problematikë, edhe ky dëgjim i sodit do të jetë në funksion të rumbullakësimit, funksionalizimit të këtij ligji që ta zgjedh çështjen e trajtimeve të ndërtimeve pa leje. Nga të pranishmit do të jetë e mirëseardhur nëse thuhet diçka çka nuk u thonë në ligj. E di që këtu ka edhe vizion politik për trajtimin e këtyre problemeve, por kemi konsideruar që këtë e kemi dhënë me vet prezantimin e dokumentit. Ne elementi ekzekutiv jemi këtu dhe nëse marim qëndrime të duhura profesionale jemi të gatshëm të inkorporojmë ato.

XHELAL LLONÇARI ky projekt nuk rregullon problematikën në mënyrën e duhur ngase detyrat nuk janë të definuar qartë si dhe përgjegjësitë institucionale. Projekti është i bazuar në “Deklaratën e Vjenës” e cila në fakt ka të bëjë me një fenomen urbanistik-trajtimin e vendbanimeve informale, mirëpo ky ligj duhet të shkojë më tutje duke trajtuar të gjitha ndërtimet pa leje-raste individuale e jo fenomene urbanistike. P/l nuk pengon ndërtimet e mëtutjeshme pa leje dhe nuk prek fare çështjen e ofruesve të shërbimeve komunale, nuk precizon përgjegjësitë e institucioneve p.sh. nga një nen ku thuhet : të gjitha kërkesat për ndërtim të cilat nuk marrin përgjigje të prerë pozitive ose negative nga ana e drejtorive komunale për urbanizëm brenda 30 ditësh , lënda kalon automatikisht në përgjegjësi të MMPH-së e cila pas ankesës së investitorit duhet të jap përgjigje brenda 15 ditësh, një mas e tillë do të rit efikasitetin e organeve komunale duke pasur qasje organi qendror në këto organe. Ose p.sh. KEK-u ka obligim të evidentoi kyqjet në objektet e ndërtuara pa leje dhe eventualisht të shkyq këta komitent (kjo vlen edhe për ujësjellës, PTK etj). Ky ligj nuk parasheh asnjë ndëshkim në frymën e ndalimeve të këtyre ndërtimeve, p.sh. një nen i këtillë : obligohet MTI që në objektet e ndërtuara pa leje të përcaktoj kohën për reregjistrimin (regjistrimin) dhe ri-licencimin pa kompensim të bizneseve të reja, pastaj me një nen të veçantë mund të parashihet të parandalohet si vijon: të gjitha firmat ose organizatat ndërtimore që ndërtojnë këso objekte do t’ju mirën licencat për sa kohë nuk rregullohet çështja e objektit ku është përfshirë edhe duke ia ngrirë llogaritë bankare të firmës. Ky ligj as nuk provon të mirët me ndërtimet në fshatra. Në kreun e dytë nuk parashihen masat nëse qytetari nuk lajmëron ndërtimet pa leje, kjo do të përmirësohet në ligj nëse futet neni përkatës me çka qytetari do të detyrohet të lajmëroi ndërtimin pa leje në afat të caktuar, nëse e parashtron kërkesën në afatin e

caktuar mund ti ipen masa stimulative, me shpenzime normale, nëse nuk e parashtrojnë kërkesën pasojnë sanksionet me shpenzime të dyfishta etj. Në Nenin 2 në vend të “bazat horizontale” duhet “planimetritë”, kurse te përkufizimi Sanimi i objektit ndërtimor duhet “Korrigjimi i objektit ndërtimor”. Një ligj që pretendon të rregulloi diçka nuk mund të filloi me fjalën “nëse”, p.sh. tek Neni 4 në paragrafin 4 duhet të precizohet : me program duhet të parashihet ndryshimi i planit urban sa i përket ndërtimeve informale duke korrigjuar ose harmonizuar këtë plan si për rastet individuale ashtu edhe për objektet tjera në zonat e caktuara të qyteteve , e para, e dyta etj. Ky ligj nuk jep përgjigje si të veprohet më tutje pas hartimit të programit për ndërtimet pa leje ose nuk ka përgjigje në rastet kur komunat nuk e posedojnë planin zhvillimor urbanistik.

RAMADAN KRASNIQI-PRIZREN në fokus të këtij dreftligji që na u ka ofruar , ideja është e qartë : legalizimi i ndërtimeve pa leje dhe parandalimin e ndërtimeve pa leje, isha ndal te neni 6 e cila duhet të jetë më decidiv sa i përket detyrimeve financiare dhe të përcaktohen tarifat e rregullta të shprehura në metër kub apo në katrorë të sipërfaqes shfrytëzuese, qofshin ato për objekte banimit apo komerciale. Tarifat sipas këtij projekti p.sh. duhet me gjet një mesatare në mes 4-shit dhe 12-shit, pra duhet të precizohen, pastaj askund në projekt nuk theksohet se MMPH intervenon me akte nënligjore, ngase ky ligj do të jetë bazik për të nxjerr rregullore dhe akte tjera për organet tjera, sidomos për ato komunale. Ky ligj duhet të ketë dy kahje : legalizimet dhe parandalimin e ndërtimeve të paligjshme. Te Neni 18 e cila ka të bëjë me refuzimin e legalizimit, në këtë nen duhet të shtohet një pikë e veçantë si pikë 3 dhe decidivisht të thuhet : kërkesat për legalizim mund të refuzohen nëse objekti është ndërtuar buzë rrugëve dhe binarëve të hekurudhës, në zonat e gjelbërimit ose rekreacionit, nëse është ndërtuar në pronën e huaj ose në vendin ku nuk ka zotrim të pronësisë, nëse nuk mund të bëhet integrimi urban në Plani Zhvillimor Urban ose Plani RRegullativ Urban, nëse është jashtë vijave rregullative të PRRU-së, nëse është në kundërshtim me kushtet kulturo historike-mjedisore. Shkojmë te Neni 22 të cilin do ta lexoj si është këtu në draft : ”Me procedurën e legalizimit do të përfshihen edhe objektet në të cilat janë tejkaluar punimet sipas lejes përkatëse të lëshuar nga ana e organit kompetent”. Këtë nen e kisha formuluar pak ma ndryshe dhe kisha shtuar “gjer më 30% të sipërfaqes së shfrytëzuar të përgjithshme të lejuar sipas dokumentacionit teknik”, pse e them këtë, ngase nëse është me leje P+1, në te ka tejkalim P+2 dhe kulm, pra kemi një ma shumë plus kulmi, pra duhet të kemi parasysh punët tejkaluese apo ka edhe mbindërtime edhe më të mëdhaja, gjithashtu duhet të caktohet edhe afati deri kur mund të legalizohet ndonjë objekt, sepse nëse nuk caktohet afati do të stimulohen këto ndërtime. Tek neni 2 përkufizimi “parcelë ndërtimore” ky definim siç është në tekst nuk është në pajtim me dispozitat e nenit 7 al. 3 të ligjit mbi tokën ndërtimore (G.Z.nr.42/86), kjo duhet të definohet : parcel ndërtimore konsiderohet ajo që është në tokën ndërtimore sipërfaqja e së cilës është e nevojshme për ndërtimin e objektit dhe përdorimin e saj në mënyrë të rregullt me kushtet e nevojshme. Mendimi i organit tonë është të kthehet projekti MMPH-së dhe të miren mendimet e organeve komunale.

LULZIM ZENELI : dikush tjetër, po urdhëroni.

NAZMI GASHI-kryeinspektor në OBILIQ sot kam prit që do të vijnë zyrtarët që nuk kanë lëshuar lejet qe 7-8 vjet në komunën tonë, por në mungesë ty tyre kemi ardhë ne inspektorët që për fat të keq kemi bajt barën më të rënd dhe do të bajmë ende për këto legalizime që po synohen . Ne inspektorët kur bisedojshim me inspektorët e komunave tjera thoshim “kur e ndërton dikush shtëpinë mere një këmishë dhe shko bonja për hajër”

, ashtu që ne duhet disi të miremi vesh me qytetarë, përndryshe situatën e kemi alarmante. Po flas për komunën e Obiliqit, i kemi pas planet urbane detale shumë mirë të punuara, dhe me një vendim nga viti 2002 kuvendi i ka fut në revidim, ndaj deri sot nuk ka revidu kurgjo në komunën tonë, do të thotë është bërë një gabim qëllimisht, mandej të tjerët e kanë shfrytëzuar këtë rast dhe kanë bërë legalizime dhe lëshimin e lejeve të cilat janë ra në kundërshtim me këtë çka po flasim sot, është mirë të gjejmë formën se si do të implementohet ky ligj, si të zbatohet nëpër komuna, unë mendoj se pa përkrahjen e inspektorëve përkatës dhe fuqizimin e tyre në teren nuk ka zbatim të asnjë ligji. Përpos vendeve urbane po kemi duke probleme të ngjashme edhe në vendet rurale, idhnohet me vlla e qohet e ndërton midis arrave diku shtëpinë e shkatërron 5 hektarë tokë bujqësore plus thotë bima kanalizimin e ujin, pra duhet të mendojmë që edhe në këto vende të tregojmë vijat e ndërtimit dhe po kemi telashe. Unë propozoi që prej sodit mos të lëshohet asnjë leje për pa u definua plani urban dhe me ju dhënë atyre (komunave) një afat 5 ose 6 muaj për të përgatitur planet të cilat duhet të kalojnë nëpër kuvendet komunale dhe të marrin votën. Një qytet të ndërtohet në rrjedhat e gabuara mundet të fut krejt shtetin në rrjedhat e gabuara, unë nuk di asnjë ligj këtu te na që po zbatohet përveç atij të komunikacionit ai që po parkon keq po i merret makina, po edhe ndërtimi është njejt nëse ndërton në vend të gabuar normal që nuk bon të legalizohet, por këtë apeloj ta bëjmë me ligj, unë mendoj se dikush duhet të ketë konsideratë për inspektorët sepse po i di hallet, vuajtjet që po i kemi, nuk mund të jetë inspektori pa një fotoaparatur në teren apo makinë ose dëshmi që po i kthehet lënda nga Gjykata, të investojmë një herë për këta të shkretë inspektorë, sepse vetëm me ta mund të zbatohet ligji.

SHEFKI ZEQRIRI MBPZHR kamë qenë si anëtarë i grupit punues i këtij projektligji por prapë jam në dilemë se a ka nevojë Kosova për këtë ligj, kur e them këtë mendoj që nuk ka mungesë të legjislacionit pos ndryshimit të rrethanave pas luftës në Kosovë, dmth kjo çështje ka mundur të rregullohet me një ligj të përkohshëm e cila kishte me pushu së vepruari pas një kohe, si anëtarë i grupit punues mund them se jemi munduar të trajtojmë në mënyrën më të mirë këtë problematikë mirëpo kam frikë se implementimi i këtij ligji do të hap vështirësi të reja, gjithashtu nuk kemi njohuri të sakta cili do të jetë kostoja e ligjit kur dihet se objektet që nuk i plotësojnë kushtet duhet të rrënohen, e cila veprimtari do të përcillet edhe me pasoja anësore përveç atyre të drejtpërdrejta. Ky projekt ka nevojë për unifikim gjuhësor, ndaj në fund mund të them se ky projekt duhet të jetë i zbatueshëm. Si përfaqësues i MBPZHR kërkoj që ky projekt të mirëtohet edhe me ndërtimet ilegale në tokat bujqësore sidomos në ato prej kategorisë I deri IV.

LULZIM NIXHA përshëndes, unë do të jem shumë i shkurtër, më duket se duhet të përsërisë atë çka kam thënë në mbledhjen e këtij komisioni se a i duhet Kosovës ky ligj në këtë moment, sepse objektiva e një ligji është çka duhet të arrihet me atë ligj : a duhet ti legalizojmë ndërtimet apo ti ndalim ndërtimet pa leje, kjo është esenca, nëse na fillojmë me i trajtua objektet që nuk janë të ligjshme, kjo do të jetë sinjal për ata që nuk kanë fillua të ndërtojnë të fillojnë të ndërtojnë, unë kësaj i frikohem sepse ne atyre duhet tu sinjalizojmë se nuk kanë perspektiv, pra duhet urgjent një ligj unik jo që çdo komunë ta sjellë planin e vet sepse do të kemi laramani, por duhet një ligj unifikues për tërë Kosovën, ne do të japim kontributin tonë zoti kryesues nen për nen dhe nuk jemi kundër saj por mendojmë se është i përshpejtuar, sepse duhet paraprakisht një vendim për ndërprerjen e gjitha ndërtimeve pa leje, edhe sot të dihet se kush është përgjegjës, ne dimë se është komuna, por prej sodit kush ka me kon përgjegjës për këto ndërtime, nëse

na kemi me arrit me ndërpre një gjë të tillë , atëherë ky ligj do të vjen në shprehje, por me fillu diçka pa qen i sigurt se nesër s'do të fillojnë edhe me mija të tillë, atëherë ka me qenë një kaos total, unë e di këtë prej përvojës prej vitit 2000 udhëheqësi i atëhershëm Brenke kur tha se do të legalizohen ndërtimet, menjher është dyfishua ndërtimi nga popullata, prandaj tash fillon pranvera kohë që inkurajon ndërtuesit të fillojnë punën, prandaj ne brenda një muaji duhet ta sjellim vendimin që ndalojnë ndërtimet pa leje, pas asaj date nuk do të ketë trajtime por rrënimë. Sa i përket tarifave ato dallojnë në çdo komunë andaj mund të apeloj që ato duhet të jenë unike në tërë Kosovën, si dhe duhet të jetë një fond i posaqëm se sa degradohet hapësira që të investojmë në atë drejtim, vetëm FushëKosova prej Prishtinës ka dallime 10 fish të ndryshme të tarifave e mos të flasim më tutje, pra unë po përfundoj duke thënë se keni kujdes se ka me qenë sinjal shumë i keq për krejt Kosovën.

Përfaqësuesi-GJAKOVË ky projekt është e përshpejtuar për shkak të problemeve të cekura. Edhe komuna e Gjakovës ka përvoja jo të mira në këtë drejtim, ngase tani tek popullata është përhap fjala se ligji po del, ndaj me vrap janë mobilizuar për ndërtime të reja ilegale. Këto ndërtime së pari duhet të ndalen me caktimin e afateve, para luftës, pas luftës etj, kush nuk bënë kërkesë për legalizim si trajtohet kjo rrethanë etj. Diskutuesi nuk dëgjohej mirë.

Haxhi Gashi-USAID është mirë që trajtohet ky problem pikërisht tani sepse këto ndërtime pa leje tanimë janë evidente , fakt është se duhet të ketë një ndërprerje të këtyre ndërprerjeve e pastaj të trajtohet ky problem, kjo çështje i ka dy anë të medaljes, pjesa e parë është se Kosova ka një investim të madhe të kapitalit në fushën e ndërtimeve, andaj ekonomia në këtë segment ka lulëzua për shkak të profitit të madhë, poçes do të ndalohej kjo veprimtari cili do të ishte efekti ekonomik, mirëpo organet për lëshuarjen e lejeve nuk kanë qenë të përgatitën në aspektin e planeve urbanistike, ose nuk kanë qenë në gjendje të bëjnë parandalimin e tyre, nuk mund të thuret askush se në Kosovë nuk ka pasur ligje, prandaj përgjegjësia është e përbashkët, këto ndërtime duhet trajtuar në mënyrë më të drejt dhe është momenti i duhur të merremi me to sa nuk është bërë vonë, nëse e lëmë ma vonë rrugët e Kosovës do të ngjajnë rrugëve malore të pakalueshme, ndërtimet pa leje duhet trajtohen në disa kënde, askush nuk thot që këto të legalizohen tërësisht dhe propozimi im është që këto nuk mund ti cenojnë interesat e qytetarëve i cili cenim shfaqet në tri nivele, përmes cenimit të planeve urbanistike, cenimi i sigurisë së përgjithshme të qytetarëve që nuk plotësojnë kërkesat teknike të ndërtimeve-merre me mend nëse do të ndodhte ndonjë termat se çka do të ndodhte, cenimi i drejtës së pronësisë së qytetarit tjetër-pra objekti në pronën e huaj. Unë kam një lloj propozimi i cili duhet të implementohet në disa pika në ligj, gjatë trajtimit të këtyre ndërtimeve duhet saktësisht të ndahet përgjegjësia e organeve, duhet të dihet cilat veprime i kryen organi lokal e cilat ai qendrorë në aspektin e implementimit të ligjit, për këtë mendoj se pa formimin e një agjensionit në nivel qendror i cili do të ishte bartës i tërë procesit dhe përgjegjësisë dhe në rast të mosveprimeve të organeve lokale ose qendrore ata do të marrin hapa konkret për trajtimin e këtij problemi, gjithashtu duhet të vendoset një lloj kufiri sepse nuk ka ndërtime pa afat, sepse gjitha ndërtimet të evidentuara nga kjo datë mund të paraqesin kërkesë, përndryshe nëse nuk janë të rexhistrueme brenda pak kohe mund bëhen ende ndërtime të reja dhe nuk mund të ndalohen, pra e vetmja formë e shpëtimit është regjistrimi i këtyre ndërtimeve, pastaj më lehtë fillojnë procedurat ligjore, gjithashtu duhet të saktësohet çka me ato që nuk i plotësojnë kërkesat, duhet të saktësohet qartë cili

organ bënë rrënimin e objekteve, e jo organet të gjuajnë përgjegjësinë njëri tjetrit, nëse nuk ka ndarje të qartë të kompetencave të organeve ligji është pa efekt.

LULZIM ZENELI ju faleminderit, dikush tjetër, po urdhëroni.

HAMDI JAHA-Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm-PODUJEVË unë nuk do të ndalem te ato gjëra që kolegët i diskutuan, te rregullat ndëshkimore e kam fjalën, edhe ne kemi pas rregulla në komunë gjatë vitit 2001 prej 1000 marka deri 5000 marka , gjykatat komunale gjithmonë shkojnë në atë pjesën e vogël të gjobës, ndaj secili person që ka interes për ndërtim nuk do të vajtoj shumë për 1000 euro që paguan sepse përfitimi është tepër i lartë, unë decidivisht kisha me shtua strikt që gjoba të jetë më e lartë se sa ndërtimin që ka bërë, vetëm kjo formë e dënimeve do të kishte efekte, si dhe dispozita tjetër shtesë: secili person që fillon ndërtimin ilegal do të dënohet 10 vjet burg, përndryshe me këto gjoba të draftit prej 1000-15000 euro njerëzit vetëm stimulohen për ndërtime sidomos nëpër rrug duke pasur parasysh infrastrukturën e rrugëve ku ka fluks të madh. Pra edhe Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerr një ligj ku dënimi do të jetë me burg e jo me gjobë. LULZIM ZENELI unë kisha pas dëshirë që para se ju të vazhdoni me diskutime, në emër të komisionit parlamentar të ju përkujtoi të përmbaheni pyetjeve që keni marr, kryesorja është se a mendoni që e zgjedh ky ligj problematikën e cekur, dhe e dyta a do të ketë telashe nesër-pasnesër në procesin e implementimit të këtij ligji, ju e shihni se qëllimi i këtij ligji është e para ndërtimet të legalizohen ato që plotësojnë konditat ligjore dhe e dyta të rrënohen ato që nuk i plotësojnë. Këtu dëgjova se duhet të mirët vendimi për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale, mirëpo rasti konkret i ligjit është të trajtohen objektet pa leje edhe në fazat që tash mund të ndërtohen, ky ligj synon një proces afatgjatë, çdo ndërtim i cili është jolegal duhet mu trajtua me këtë ligj, edhe pse ne dimë telashtet e juaja komunale, të prekim problemin direkt dmth a e zgjedh këtë problem ky ligj. Nëse po atëherë ta pasurojmë këtë ligj, ngase ne kemi përvojë që ka treguar se një ligj mund të miratohet por të vazhdoi avazi i vjetër. Prandaj ju kisha lut drejtpërdrejt të fokusohemi në ligj, nëse nuk e zgjedh ky ligj problemin atëherë ta kemi një qasje tjetër. Ne nuk synojmë që me këtë debat gjithçka të përfundojmë, përkundrazi do të vazhdojmë me takime të nevojshme deri atëherë kur konsiderojmë se gjitha mundësitë janë shtjerr.

HAXHI GASHI nga USAID unë vetëm desha me reagua se ky ligj duhet të jetë dhe është jetëshkurtër, ngase ky ligj duhet të trajtoj vetëm këto ndërtime që janë tash për tash, mendoj se pajtohet edhe ministria se qëllimi i ligjit është ky, me çka duhet të caktohet një afat për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje.

HAJZER BUBLAKU nga Agjensioni Kadastral, unë do të ndalem te disa çështje konkrete të cilat duhet të eliminohen ose të plotësohen sepse kemi të bëjmë me të metat e këtij ligji, te pasusi i **Neni 1.2** thuhet se në të ardhmen “të ndërpriten ndërtimet pa leje”. Ky projekt nuk e ka përfshirë aspak këtë materie (ndalimin e ndërtimeve pa leje), këtë duhet të rregulloi Ligji për Ndërtimet dhe ai i Planifikimit Hapësinor, nëse keni mendua që kjo gjë të rregullohet me masa ndëshkimore, atëherë kjo është gabim, meqenëse ky ligj bjen në konflikt me ligjin për ndërtimet, pra ky ligj do të ndërhyjë në atë ligj, pra pasusi i fundit duhet të hiqet sepse ky ligj duhet të vlej për ato ndërtime që janë bërë deri në atë moment kur ka hy në fuqi. Ligji i ndërtimeve ka hy në fuqi më 2004 por nuk u zbatua, dmth prapë nuk është në rregull, por nuk përmirësohet gabimi me një gabim të ri, një element tjetër që ka lëshuar MMPH është se nuk kemi afatin për objektet që do të shqyrtohen, këtu do të keni kërkesa për objektet e viteve 80-ta e tutje, pra shumë objekte të fazave të ndryshme, ky ligj imponon kushte të njëjta për të gjitha këto që unë ceka, këtu

duhet ta dallojmë objektin pa leje dhe objektin pa leje por me projekt (projekte të cilat kanë qenë në fuqi), i cili prapë duhet ti nënshtrohet ligjit për ndërtim në fuqi që është prej 2004, kjo nuk është në rregull sa i përket objekteve të viteve 80-ta, ne kemi pas rregulloren në fuqi e “Rexhep Lucit” (në sallë reagues disa se nuk ka qenë asnjëherë në fuqi), po po ka qenë e nënshkruar nga PSSP unë e di ashtu. Tek Neni 2 në përkufizimin Projekti i gjendjes ekzistuese fjala “paramenduar” mund të zëvendësohet me “planifikuar”. Çështja tjetër Neni 5.5 kur përcaktohen përgjegjësitë e komunave thuhet se komuna të caktoj afatin për planin rregullues, duhet të fshihet, ngase kjo çështje është e rregulluar me nenin 3.4 ku parashihet afati 6 mujorsh. Neni 6 lidhur me detyrimet financiare duhet të caktohen ndoshta edhe kategoritë, është shumë e përgjithësuar dhe jo e qartë duke mos e përcaktuar kriteret për secilën kategori të objekteve, po marr një shembull pa dashur ti mbroj qytetarët, e dimë rastet të viteve 2000,2001,2002 kur qytetarët kanë kërkuar të pajisen me leje, ndërsa komunat nuk kanë dhënë përgjigje me vite të tëra, ose kanë dhënë përgjigje me shkrim, që vet e kam pa, nuk mundemi me dhënë përgjigje sepse mungon plani urbanistik, pra a duhet ta konsiderojmë një qytetarë të tillë se ka kërkuar lejen me kohë apo ta futim në të njëjtin kosh me të gjithë, pra unë them se duhen disa kriteret, sepse ata që kanë deshtë të zbatojnë ligjin duhet të kenë një tretman pak më ndryshe. Ligji i ndërtimit përmendet për shumë çështje edhe për objekte të vjetra, por nuk e di sa mund të aplikohet në gjithë ato raste. Afati për legalizim e keni parapa 30 ditë i cili afat mund të jetë i përshtatshëm për komunat e vogla, por në komunat e mëdha organet nuk janë në gjendje teknikisht të bëjnë këtë gjë, sepse do të jenë me mija raste, kishte qenë mrekulli nëse organet do të mund të marrin vendimin për 30 ditë. Kërkohen disa ekspertiza për disa procedura që kjo përsëritet disa herë nga MMPH e cila nuk e di a kanë fillu me licencim, kërkohet që ato ekspertiza ti bëjnë personat e licencuam. Nëse Kuvendi Kosovës këtë ligj e miraton për një muaj e ju nuk jeni askund me licencim atëherë si do të zbatohet kjo. Tjetër, çka do të bëhet me objektet që nuk legalizohen, neni 30 parasheh që ato do të rrënohen, mirëpo nuk u caktua afati kur do të rrënohen ato, kjo nuk ka kuptim sepse organi brenda një afati duhet ta rrënoji objektin, pra duhet të caktohet përgjegjësia konkrete për secilin subjekt, një duhet ta kemi të qartë : ndërprerjen e ndërtimeve pa leje e bënë ligji për ndërtimet, nëse nuk zbatohet ky ligj është e kotë. Vërejtje të ngjashme kam edhe tek Neni 11.3, ndërsa tek Neni 15.1 afati për lëshuarjen e vendimit (30 ditë) është shumë e shkurtër, sidomos për komunat e mëdha ku ka shumë ndërtime pa leje, ky afat duhet të jetë së paku 60 ditë. Neni 19.2 thekson vërtetimin e personit të autorizuar apo licencuar....., por çka për objektet që janë ndërtuar më heret sipas projektit. Nuk kemi njohuri se MMPH a ka filluar licencimin e personave të autorizuar. Neni 23.3 kërkon që leja e përdorimit ti plotësoi kushtet nga Ligji i ndërtimit, kushte këto që mund të jenë më ndryshe se ato të ligjeve të mëparshme. Përfaqësuesi-FERIZAJI kërkoi formimin e mekanizmit për ndalimin e ndërtimeve pa leje. Në Nenin 2 të definohet shprehja Koridori i infrastrukturës urbane. Neni 3.3 afatin e miratimit të programit duhet të zgjatë. Neni 3.4 gjithashtu e ka afatin e shkurtër. Neni 5.4 kriteret për legalizim duhet ti caktoj në nivelin qendror dhe të jenë unike. Neni 7.1 3 muaj për regjistrim të objekteve kurse 2 muaj për aprovim të programit. Neni 12 të shtohet pika për ndërtime në tokat bujqësore. Neni 16 paragrafi 2 dhe 3 të fshihen. 19.4 të kategorizohen objektet për të cilat është e nevojshme elaborate gjeomekanike.19.7 të sqarohen detyrimet financiare. 19.2 të fshihet teksti dhe pika 3, të definohet termi shtëpi familjare. Neni 20 paragrafi 3 është i paqartë. Neni 25 të shtohen shpenzimet e

komisionit, të precizohet se çka do të bëhet për ata që në afatin e caktuar nuk bëjnë kërkesë për legalizimin e objektit ndërtimor pa leje. Të precizohet periudha e ndërtimit të objekteve që i nënshtrohen këtij ligji.

SEVDIJE MALIQI-HYSENI Drejtoresh e Drejtoratit për Urbanizëm GJILAN projekti është i ngutshëm edhe për drejtorinë tonë. MMPH e din se secila komunë nuk i ka planet ose i kanë të vjetra, ndaj për ne është dilema në bazë të cilave plane të legalizohen, planet në komunën tonë janë të vjetra mbi 20 vite, të cilat nuk janë realizue edhe para lufte edhe pas lufte. Ligji i ndërtimit, është e qartë se duhet ti ndërprej ndërtimet pa leje, mirëpo duhet të gjindet një mekanizëm për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale, pra duhet të obligohen komunat por ky obligim të përcjellet me ndihmën e Qeverisë e cila do të ndihmonte komunat për këtë obligim edhe financiarisht, sepse zhvillimi i gjithmbarshëm i shoqërisë bëhet vetëm me planifikim. Për këtë arsye unë kisha thënë të punohet më tepër në inspekcione, na p.sh. kemi tre inspektor me shkollë të mesme, ne kemi pas konkurse por nuk vijnë ata që duhet me ardh-të licencuarit. Fillimisht propozoi që të gjithë komunat të marrim një vendim për ndalimin e ndërtimeve pa leje, të obligohemi komunat të hartojmi planet, e pastaj të filloj trajtimi i objekteve.

HAMDI SYLEJMANI-Përfaqësuesi i Shoqatës së KONSTRUKTORËVE të ndërtimtarisë të Kosovës- ligji është i domosdoshëm sepse ka marr përmasa të padëshirueshme-katastrofale kjo dukuri sidomos nga aspekti i stabilitetit të objekteve që janë realizua, fatmirësisht nuk ka termet, por një termet i vogël në Gjilan na tregoi se çka mundet me ndodhë, për këtë shkak ne duhet të punojmë në dy binare paralele, në një menjher të zbatohet ligji për ndërtimet për të mos lejuar zgjerimin e këtij problemi, e dyta të shkurtojmë procesin për të gjitha objektet pa leje e që mund të inkorporohen, sepse janë investime të mëdha, dhe ato ti legalizojmë, por sa më herët të vendoset për ato që s'munden dhe të pastrohet puna, sipas gjitha gjasave problemi ma i madh do të jetë Prishtina, për me mujt me ruajt disi këtë qytet sepse është i vetmi qytet në Evropë që ka edhe nga tri nënkulme, edhe në vise malore nuk ka çka këtu në Prishtinë, kjo ndahet në dy problematika 1. një numër shumë i madh i objekteve që nuk kanë leje dhe 2. objektet me leje por me shumë tejkallime, për gjitha këto duhet të ekzistoi projekti kryesor që e parasheh ligji, pra duhet të thjeshtohen procedurat. Projektligji është hartuar në shumë vende pa analiza të duhura, në rast se analizojmë termin parcela ndërtimore, në shumicën e vendeve ku kemi mbindërtimet, pronar nuk mundet kursesi të jetë ai që ka ndërtua sepse nuk ka parcelë ndërtimore ai, çka me ato objekte që nuk hyn në asnjë kategori, për këtë sugjeroi që juristët të definojnë më qartë problemin. Sa i përket dënimeve që parashihen, parashihet dënimi për projektantin që ka bo projektin, çka ka ai faj që ka ndërtua investitori pa leje, sepse projektanti nuk e nxjerr lejen.

Përfaqësuesi OBILIQ- z.Lulzim veç pak, këtu është problemi që ne po dojmë me hi e nuk po mundemi, për me punue duhet me qenë i licencuar , qysh e bon ndërtimin pa e pa projektin, pra këtu janë kundërshtimet më të mëdhaja.

HAMDI SYLEJMANI desha vetëm edhe pak me vazhdua, ne jemi tue punua edhe për kodeksin e sjelljes së projektantëve, sidomos konstruksioneve, si me mar atë drejt ai person që punon kundër ligjit, që do të thotë se kjo nuk është stimulim për ata që punojnë jashtë ligjit, në rast se investitori ka punua jashtë ligjit automatikisht i takon kjo gjobë projektantit, në Prishtinë shumica kanë leje P+2 mirëpo pastaj janë bërë tejkallime, kjo duhet të gjobitet. Pra ligji duhet të miratohet sepse tri herë ma vështirë do të kemi pastaj

më vonë. Çdo komunë duhet të punoj programin rreth legalizimit, vërejtjet tona janë si vijon:

Neni 2 në përkufizimin Projekti kryesorë i objektit për legalizim është projekt i cili është punuar sipas ligjit për ndërtim.

Neni 6 detyrimet financiare sipas nenit 5 pika 6 duhet të jenë sipas tarifave komunale për objektet e banimit, përkatësisht të objekteve komerciale.

Neni 12 të shtohet alineja e re : Pengon shfrytëzimin normal të objekteve ekzistuese.

Neni 18 të ndryshohet alineja 1: Me incizimin e gjendjes ekzistuese të objektit ndërtimor pa leje vërtetohet se nuk përputhet me gjendjen reale me gjendjen sipas projektit kryesor.

Neni 19 të ndryshohet paragrafi 1 pika 1 dhe të hiqen pikat 2 dhe 5 **1**. Tri kopje të projektit kryesor (për objekte që kanë ndryshime në krahasim me projektet-mbindërtimet, gjendja e mëparshme dhe gjendja e re) sipas Ligjit për Ndërtimin.

Neni 23 të ndryshohet pika 2 e paragrafit 1 2. Të dhënat për personat të cilët e kanë punuar projektin kryesor të objektit për legalizim.

Të ndryshohet paragrafi 2 i nenit 23 2. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni i dorëzohet edhe investitorit i cili është i obligueshëm që për vendin ditën dhe orën e fillimit të kontrollit teknik ti lajmëroi :

- pjesëmarrësit në ndërtim , në rastin kur objekti është përfunduar pas vendimit për legalizim,

- projektuesin për objektet e përfunduara para vendimit për legalizim. Investitori është i obliguar që të siguroi pjesëmarrjen e tyre në kontrollin teknik,

Neni 25, të ndryshohet pika 2 dhe të fshihen pikat 3 dhe 4:

1.Projektin kryesor të objektit për legalizim.

Neni 26 të ndryshohet pika 2 e paragrafit 2:

2.Vërtetohet se janë bërë ndryshime dhe plotësime në objekt pas dhënies së vendimit për legalizim, që ndikojnë në shfrytëzimin e objektit,

Neni 28 të fshihet paragrafi 2 dhe 3.

LULZIM ZENELI unë një pyetje ju kisha bërë të gjithëve që mos të ndërhyj shpesh : cilat komuna aktualisht japin leje për ndërtim. Përgjigja nga të pranishmit në sallë ishte unanime : TË GJITHA.

Përfaqësuesi-PODUJEVË ate që tha profesori Hamdi, projektet që bahen është problemi se njerëzit i përgatisin lejet pa kushte urbanistike , denimet duhet të jenë strikte te projektantët , te firmat që ndërtojnë , nëse këto dy sektore rregullohen atëherë do të kemi më pak ndërtime pa leje, problemi kryesor është i projektantëve dhe ndërtuesve pa leje, që i kanë marr licencat për ndërtim (dihet qysh i kanë marr licencat).

BISLIM BAJRAKTARI-Drejtori i Inspektionit të Prishtinës (bëri shaka : më i shami më i lëvduari) më duket se ky muhabet dhe ky draft është pak sa i vonuar sepse do të duhej të nxirrej shumë më herët, pajtohem plotësisht se duhet të ndërpriten ndërtimet pa leje, të ndodhë një prerje mes asaj që ka ndodh dhe më tutje, gjitha objektet duhet të trajtohen, prej pasluftës në Prishtinë kemi 7000 objekte, shumica kanë tejkalime, skemi qare pa shkuar rast për rast, sepse këta qytetar nuk janë nga Bangladeshi, ne si komunë nuk kemi arrit qytetarëve të krijojmë kushte për punë normale sepse deri vonë nuk kemi pas plane rregullative, nuk po du me ju përzi z. Luli sepse unë pajtohem që ky ligj nuk i ka zbërthye specifikat e dhura, por ajo duhet ato ti zbërthej me akte nënligjore ose rregullore përkatëse, por ne qare skemi pa e bërë atë që duhet bërë, ne nuk mund ta rrënojmë objektin e Gorenjes atje-objekt milionësh, unë ate sot gjys natës e nënshkruaj për

legalizim, pavarësisht që ska pas plan rregullativ atje, ato që duhet të legalizohen duhet të legalizohen, ato që nuk plotësojnë kushtet merremi vesh për rrënimin e tyre, unë jam ai që do ti rrënoi, por të jenë gjërat qartë të definueme së pari, ne duhet të përballemi me këtë problem, përndryshe pajtohem me gjithë parafolesit, ne do të komunikojmë me asociacionin e drejtorive të inspektionit me shkrim do ti japim vërejtjet përkatëse. Prapë po them ligji na duhet si buka dhe uji, pra skemi qare pa i trajtua, krejt komplet Vranjevcin e kemi pa leje, gadi krejt Emshirin etj, nesër a do ta rrënosh krejt këto lagje, ato janë qe 30 vjet pa leje , ato duhet të trajtohen deshëm apo s'deshëm, por megjithatë ky ligj është ligj i vonuar, e përshëndes MMPH-në për këtë projekt por duhet shtesë për implementimin e tij, ai që është në tokë të vet, ai që mund të inkorporohet në plane rregullative etj pse mos të legalizohet, unë nuk jam Neroni i Prishtinës, faleminderit.

LULZIM ZENELI urdhëro profesor, pasi që Prishtina ka pak ma shumë probleme.

LULZIM NIXHA kemi probleme shumë të mëdha, por probleme kemi na në komunë që smiremi vesh ne mes drejtorateve që janë dhe që si kuptojnë gjanat, qe pse : këtu u tha që ska planifikim, te na nuk është ashtu, na e kemi planifikimin dhe pikërisht ato hapësira që janë planifikua atakohen me ndërtime ilegale, dhe Inspekcioni nuk është gjendje të ndalë, pyetja është pse, drejtori mund të jep përgjigjen, me ligjet ekzistuese përgjegjësia është tek inspektorët, asnjëri nuk është përgjigj për ndonjë ndërtim ilegal deri sot, a janë inspektorët apo kush janë mbas inspektorëve, njerëzit prej qendrës (Kuvendi apo Qeveria) nuk e di por kuptone se problemi është shumë i madh, ose duhet ti mëshojmë vi dhe të përgjigjemi prej sodit secili për veti ose nuk ka zgjidhje, na mund të flasim ditë e natë këtu, por problemi shumë i madh është, nuk mund ti veshim një rës palë fajin sepse çdo palë do të gjej arsytim, me ligjet në fuqi, edhe pse ka leje, nëse ka tejkalua ajo leje nuk vlen-është objekt pa leje , nuk ka arsytime banale sepse na po dëshirojmë me punua me ligjet në fuqi e jo e kom marr lejen për një kat e kom bo pastaj 5 kat, ajo është objekt pa leje-kërkoj falje, sepse i ka ndryshua gjitha parametrat urbane, vetëm tju them diçka, ne kemi trajtua për çdo lagje ndërtimet por çka ka ndodhë, derisa është kryer plani, 100% janë dyfish ndërtimet, pra ne mund të bëjmë çdo ditë planifikime por çdo ditë parametrat do të ndryshojnë, çmimi po shtohet, ne do ta paguajmë ose gjeneratat e ardhshme, prandaj është urgjente ta ndërprejmë sa ma parë këtë dukuri-aq sa mundemi.

MAZLLOM BARALIU ligji është i domosdoshëm dhe imperativ, duhet të zbatohet bashkë me ligjin e ndërtimit, është një brumë i mirë ky draft por ka çka të kompletohet, nuk do të lëshohem në detale por në disa pika kyqe, në radhë të parë Neni 3 paragrafi 4 të hiqet, neni 5 është i papërpunuar mirë për detyrime financiare sepse ka qëllime ambivalente, dhe len përshtypjen se dikush dëshiron që ky ligj të mos zbatohet, do të duhej të ndahen tri zona e jo prej – deri siç është dhënë në draft, sepse nuk është njejt një objekt që u ndërtua në periferi sikur ai objekt që është në qendër ose mezoqendër, secili objekt duhet të paguhet sipas metrit katror sipas vendit ku gjendet, pastaj kemi ato përdhese që zakonisht janë për biznes dhe katet që janë për banim, në Nenin 12 duhet ti shtohet një paragraf sa i përket procedurës, ngase nuk është përpunuar sa duhet ose fare pak sa i përket mjeteve juridike të qytetarëve për ta realizuar drejtën, poashtu këtu duhet paraparë në fund një paragraf të ri, afatin në nenin 13 e cila është 12 muaj, afatet duhet të jenë varësisht prej përgatitjeve sepse ky afat nuk është serioz, sepse ky ligj ka për qëllim vetëdijsimin e qytetarëve, të cilët duhet të fillojnë me bërë raporte obligative ndaj shtetit e jo vetëm të fitojnë dhe të pasurohen me qiratë që po i marrin, nëse ka bërë qytetari një objekt pa leje duhet të paguaj koston për legalizim përmes zonave me metër katror sipas

vendit ku e ka e jo njësoj për gjitha objektet (metri katror në qendër është më e shtrenjtë se sa në periferi). Kjo do të ndikonte shumë, jam i bindur, në masë të madhe për ndaljen e këtyre dukurive për të bërë qytetari sa më shumë objekte. Në vazhdim kam vërejtje të neni 14 ku poashtu rregullohet me disa akte juridike procedura juridike për tu ankuar njerëzit, gjithashtu neni 19 ku formohet një komision qeveritarë për licencime që do të vërtetonte të gjitha parametrat urbanistike për çdo objekt, këto janë të qëndrueshme sepse këto objekte nuk do të mund të përballojnë tërmetet e 4 apo 5 shkallëve, prandaj nuk duhet lejuar që për pak lëvizje tektonike të shkatërrohen ndërtesa të tëra sikurse në vendet Afrikane apo gjetiu, pra ky komision do të bënte këtë kontrollin teknik dhe nuk është në kundërshtim me nenin 24 që parasheh kontrollin e teknike. Dhe fare në fund ndëshkimet, Neni 29 është e paartikulluar për shkelje të lehtë të detyrës zyrtare, ku duhet të dënohet personi zyrtarë, kjo është e pa determinuar sepse kemi person zyrtarë juridik dhe institucionin dhe dy lloj të kategorive të përgjegjëse, këto dyja duhet të përfshihen dhe të përcaktohen shumatat sa. Unë ju falënderoj dhe do ta jap edhe me shkrim.

ZYHRIE MALOKU faleminderit për kontributin, vazhdojmë më tutje me diskutuesit me radhë, t'ju përkujtoi se ora është 14, ndaj ju lus të keni parasysh kohën.

XHELAL LLONÇARI çdo njeri ka drejt banimin, ndaj ky ligj duhet të kufizohet vetëm në trajtimin e objekteve informale me çka do të thjeshtësohej procedura, pastaj në një rast tjetër të hartohet një ligj tjetër për ndërtime ilegale, ju faleminderit.

ZYHRIE MALOKU ju faleminderit, kush e don fjalën.

MAZLLOM BARALIU vetëm desha me plotësua diskutimin, në Kroaci kemi një rast drastik nga viti 1999 ku është ndërtua me leje të Komunës në Pantovčak objekti që ka kushtu për atë kohë 6 milion, me vitin 2003 është prurë rregullativa që përcakton parregullësin e këtij objekti, dhe është prurë vendimi me rrënua objektin, dhe është rrënua edhe pse ka pas projektin dhe lejen, ky shembull tregon për neve se nuk duhet bazuar në vlerat që janë investua por duhet me pas kujdesin kryesor për programet e caktueme, sepse çdo kush që ka parë do të fillojë të ndërtoj.

ZYHRIE MALOKU faleminderit,

LULZIM ZENELI debatit po i afrohet fundi, nëse nuk ka diskutime kërkoi nga anëtarët e komisionit ndonjë koment apo pyetje.

GAZMEND MUHAXHERI unë kam një pyetje për drejtorin z. Bajraktari, çka e pengon këtë inspektorat për me reagua lidhur me ndërtesën 10 katëshe në "Dragodan" dhe kësaj ndërtese që është përball Radio Prishtinës e cila i ka mbyll dritaret banesave tjera përreth, pra çfarë pengese ligjore ke për me i rrënua ato, a ke nevojë ndihmë nga Kuvendi i Kosovës.

BISLIM BAJRAKTARI faleminderit për këtë pyetje shumë konkrete, por nuk është vetëm një rast, po të ishte problemi vetëm te rasti konkret shumë lehtë e kishim bërë, në këtë po diskutojmë për ndalimin e dukurisë së ndërtimeve pa leje, si të ndërpritet dukuria, sepse rasti është lehtë, por si me i rrënua 7000 ndërtime, unë me letra krejt i kom rrënua por çka të bëjmë që çdo urdhër ndalesë e inspektionit praktikisht nuk realizohet, sepse askush nga pushteti nuk më ka ofruar siguri që dikush nesër nuk ma jep një plumb në kokë, pra ne nuk kemi struktura detyruese për ti realizuar vendimet, këto as nuk e merr policia mbi vete, as të tjerët, ne duhet të krijojmë një task forcë që urdhëresat tona administrative për ndërprerjen e punimeve të zbatohen më në fund, unë nuk shkoj aty si kujdestar me hongër tullën kres, këtë ju duhet ta keni qartë këtu dhe askush nuk ka nevojë të mshefet.

Përfaqësuesi i PODUJEVËS vetëm një sqarim, ne kemi pas në komunë dy raste kur kemi apelua që nëse i hiqni shiritat do të shkoni 3 vjet burg, me atë rast ata janë disiplinua dhe brenda javës kanë kryer obligimet e duhura, pra edhe ne kemi fajet tona, prej neve kërkohet këmbëngulësia e jo të frikohemi, përndryshe është shumë ma mirë një Hamdi të largohet nga puna se sa kështu, ne duhet të koncentrohemi në punët tona dhe të ndihmojmë njëri tjetrin, çka nuk jemi duke bërë momentalisht. Nëse stafi komunal jemi këmbëngulës kanë mu ndërpre , por nëse nga qendra (Kuvendi) vjen intervenimi dhe lëshojmë pe, atëherë fillon frika zingjirore duke përdorur kërcënimet.

LULZIM ZENELI faleminderit, po urdhëroni.

BISLIM BAJRAKTARI neve na duhet forca detyruese për zbatimin e aktvendimit tonë, unë me numër të vogël të inspektorëve nuk kemi mundësi me mbikëqyr Prishtinën dhe me zbatua urdhërndalesën tonë, se ai n'gjymse natës prapë fillon punon, nuk kemi strukturë që mbikëqyrë atë punë ndërtimore pa leje, pa këtë hallkë kot e kemi.

LULZIM ZENELI faleminderit, dikush nga anëtarët tjerë të Komisionit, po Fetah Berisha urdhëro.

FETAH BERISHA më lejoni ju lutem para se ta them pyetjen për gjithë ju, ti them disa fjali përpara, e para, këtu u potencua se a e ka kohën ky ligj në Kosovë, nga dikush tjetër u tha se ky ligj është i domosdoshëm, ma merr mendja se pajtoheni të gjithë se planifikimi hapësinor dhe ndërtimet pa leje janë katastrof në Kosovë, kjo nuk është e sotme por një trashëgimi shumë e kaluar, këtu u përmend para lufta dhe pas lufta, unë kisha me thënë se ndërtimet pa leje të natyrave të ndryshme duhet ti marrim që sot e në të kaluarën sa të mundemi, a mundemi ti parandalojmë ato që bëhen sot e tutje-me çka, këtu u tha është mirë të formohet një agjension me një dokument të ngutshëm apo urgjent të parandalohen këto ndërtime, pastaj u tha a jepen leje nëpër komuna, po, pastaj vonimi i lejeve me vite, pse bëhet kjo, kush na pengon më, nuk e kemi pushtetin serb këtu më, tash po dal te pyetja, pasi që legalizimi nxit ndërtimin pa leje, rrënimi kush-inspektoriati, moszbatimin e ligjit a mund ta rrënoi ky zotniu (inspektori), jo, sepse askush nuk përmendi ka korrupsion këtu apo jo, me siguri se ka, nëqoftëse edhe ndonji vjet shkon kështu p.sh. nuk do të kalohet më nëpër Prizren, kështu e kemi gjendjen në tërë Kosovën, pra si të bëhet legalizimi që cenonë infrastrukturën e përgjithshme dhe drejtën e pronarit, por ka edhe aso që krejt është në rregull por leje ska, pra duhet ti dallojmë këto gjëra, t'ju hymë këtyre gjërave, tash e tutje ti bëjmë legalizimet që mund të bëhen dmth që nuk cenonë pronën private dhe infrastrukturën shoqërore, pastaj ti bëjmë parandalimet. Pyetja ime është : çka mendoni ju, me çfarë dokumenti mund të vihen në jetë këto që u cekën dhe si mund të vihen në jetë këto, sepse ai zotëriu që shkon me rrënuar me bager është i rrezikuar. A funksionon ligji apo jo, sepse tërë policinë e kemi pas vedi. Dikush përmendi edhe gjrobat, dikush tjetër tha kur ndërton dikush shko bonja përhapër.

BERAT LUZHA unë kamë përshtypje se na mungojnë lejet, ose vonohen ose nuk ipen përgjigjet fare nga komunat , secili që ndërton ka dëshirë ta legalizojë atë ndërtesë, unë e di se në shumë raste ndërtimtarët ankohen se nuk marrin leje nga komuna ose u vonohen me vite ato, prandaj kjo është një prej problematikave të cilin duhet ta rregullojmë, pastaj në shumicën e rasteve mungojnë planet urbanistike dhe planet tjera që e përmendi një zonjë këtu të cilat pengojnë në dhënien e lejes, dhe në mungesë të dhënies së lejes pastaj bien ndërtimet pa leje, kjo është për mua preokupimi kryesorë në këtë rast, faleminderit.

SELVIJE HALIMI ne sot e kishim një dokument bazë që synon ti rregulloi ndërtimet pa leje dhe pjesa e parë e këtij debati ishte tamam profesionale, por pjesa e dytë filloi të

kaloi në raste individuale apo të kërkohej përgjigjet në ligjet tjera, ne po shtrojmë problemin se a do të mund të zbatohet ky ligj kur të hyn në fuqi, ne kemi mbi 130 ligje që janë në fuqi por secili zbatohet diku rreth 10 apo 15 %, për të zbatuar një ligj për trajtimin e ndërtimeve pa leje janë edhe një mori ligjesh që janë shkel deri tash në dëm të interesave të qytetarëve dhe në dobi të atyre që kanë deshtë përfitime , unë nuk e kundërshtoi nevojën për këtë ligj por pse janë bërë kaq shumë ndërtime pa leje, a janë zgjëruar njerëzit apo ka qenë nevojë e domosdoshme për të ndërtuar, unë nuk dua të bëjë pyetje inspektorëve etj sepse pasojat vet ata do ti bartin tash sepse tani pason ballafaqimi me probleme, ata le ta mendojnë tani si të dalin prej këtij kaosi që është lejua deri sot, nëse unë skam mund të parandaloi një ndërtim pa leje, është dashtë publikisht të deklaroi se nuk mund ta ushtroi funksionin që më është besua, nuk është e vërtetë se vetëm Kuvendi qendror ka kërkuar lëshoje se është i imi, sepse Kuvendi qendror vonë është themeluar, pra mos të gjuajmë fajin andej ose kënde, unë mendoj se ende kemi nevojë për debate me ekspert si të bëhet zgjidhja ose kategorizimet, të merren bazë afatet etj të shkojmë kah ajo çka mund të implementohet, pse ti se kryen detyrën, sjam i siguruem, në Kosovë sot askush nuk ka siguri në kuptimin individual, të bëjmë një ligj të implementueshëm për të gjithë, unë po i them edhe Lulit si nënkryetar i komisionit se vërtetë kemi nevojë për debate profesionale për këtë ligj, nuk është hera e parë që Qeveria na qet para aktit të kryer me ligje të këtilla gjysmake të paparamenduara, por të ulemi dhe ta bëjmë punën që duhet bërë por duhet me ditë ai që ndërton sot a hyn në kuadër të këtij ligji apo jo, dhe pajtohem me atë që u kërkuar këtu që të merret vendimi unik për ndalimin e ndërtimeve pa leje dhe të shikohet nëpër komuna sa po zgjasin me zhargitje sipas lejeve për ndërtim, një vjet me u vonua një leje nuk ka kurfar arsyetimi nëse i ki ligjet.

Përfaqësuesi-OBILIQ veç një kërkesë, a ka mundësi dikush prej juve prej komisionit parlamentar të formoi një nënkomision apo si të doni dhe të vizitoni komunat në Kosovë për një afat të caktuar ku i merrni problemet prej komunave dhe pastaj më lehtë e keni.

RAMADAN HASHANI inspektor i ndërtimit-mendoj se ne duhet të merremi me veprime në dy fusha, ndërtimet ilegale ta vejme nën kontroll por ky ligj duhet të jetë i limituar sa i përket zbatueshmërisë, kjo do të thotë se nëse ne legalizojmë deri në infinit edhe do të ndërtojmë deri në infinit. Në këtë ligj duhet të futet një pasus për vitin prej të cilit do të legalizohen objektet deri në periudhën kaq, pra të eviton problemet që pasojnë pastaj, pra zjarrin duhet ta shuajmë dhe të marrim preventiv mos të ndodhë më tutje. Në këtë aspekt duhet të angazhohemi e gjithë preparatet shtetërore dhe mekanizmat në mënyrë që mos ti jetë bara vetëm drejtorateve për urbanizëm. P.sh. e marrim një objekt kolosal që merret me biznes por nuk ka leje të ndërtimit, nëse merren masat ti mbyllet veprimtaria ai objekt vdes, pra ka metoda të ndryshme se si mund të sanksionohen objektet pa leje, masa e rrënimit në botën bashkohore është shumë e hidhur dhe është fazë e fundit, pra ti qasemi metodave që eliminojnë ndërtimet pa leje mos të ndërtoj një objekt të tillë se do të jetë objekt i vdekur.

SEVDIJE MALIQI-GJILAN-edhe një herë desha me potencua se MMPH duhet të shqyrtoi në çdo komunë ku janë dhe deri ku kanë arrit me plane, sepse ligji mundet me u finalizua por sa do të ketë fuqi ai ligj. Ne jemi ende në fazën e hartimit të planeve, çdo planifikues e dinë se duhet të bëhen analiza për tërë komunën ose qytetin dhe mund të ndodhë që tu epet përparësi ndërtimeve të larta, nëse ato p.sh. legalizohen ajo do të jetë në kundërshtim me një analizë tani ne që jemi duke shqyrtuar, kështu që unë kisha thënë me përjashtim të komunës së Prishtinës që ka plane pak më tepër, komunat tjera nuk kanë

plane rregullative sepse ato që i ka i ka të kahershme (jo të këqija) dhe të cilat asnjëherë nuk janë zbatuar-janë shkelur, sidomos pas luftës. Pra ne si komunë nuk jemi kundër këtij ligji por apelojmë te MMPH dhe Qeveria të planifikojnë mjete financiare më tepër për fondin e planeve nëpër komuna dhe të shkohet ose në revidimin e planeve të vjetra ose ti inkorporojmë ato gjendjes ekzistuese dhe pastaj ti trajtojmë këto ndërtime, faleminderit.

LULZIM ZENELI faleminderit, ne erdhëm në fund të debatit. Sipas procedurës parlamentare komisioni do ta marr transkriptin dhe të shikoj sërish çdo diskutim veç e veç në detale, dhe mbi bazën e opinioneve të juaja ne do të marrim një qëndrim si komision. Kjo ishte një dëgjim publik që neve do të na ndihmon shumë, unë besoj se shumë dilema janë largu, sidomos ato që kanë mbretërua tek anëtarët e komisionit, por në anën tjetër përfundimisht vërtetova se kemi të bëjmë me një ligj i cili deri në aktin final të miratimit do të na nxjerr shumë telashe, ngase edhe nga kjo debat u pa se zanafilla e këtij problemi daton shumë më herët , prandaj unë ju falënderoj dhe besoj se ky debat nuk do të përfundoj me kaq, ne do të shqyrtojmë prapë të gjitha dilemat që ende do të shfaqen, por në ecjen tonë të përbashkët, sepse qëndrimi final i komisionit do të jetë rezultat i kooperimit të ngushtë me udhëheqjen lokale, e jonja është të nxjerrim një ligj të zbatueshëm dhe funksional pik së pari për juve nëpër komuna atje ku ballafaqoheni me probleme konkrete, dhe sidokudo pak ta ndryshojmë këtë pamje që aktualisht mbretëron, ju faleminderit.

Ora 14,30

